

VENDIM
Nr. 899, datë 29.12.2022

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA
PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar u jepet mbështetje financiare e menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës, sipas kategorive të mëposhtme:

a) familje me gra kryefamiljare, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë;

b) familjet e tjera, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;

c) familje, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;

ç) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;

d) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 1 160 400 000 (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku